



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 17 datë 11.06.2025

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “KOMPLEKS BANIMI
1 DHE 2 KATE MBI TOKË, ME 1 KAT NËNTOKË DHE MUR RRETHUES”, ME
VENDNDODHJE NË PETRELË, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese P.F. “Ardian Lloshi” dhe P.F. “Resul Çarçani”, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Kompleks banimi 1 dhe 2 kate mbi tokë, me 1 kat nëntokë dhe mur rrethues”, me vendndodhje në Petrelë, Bashkia Tiranë, me subjekte zhvilluese P.F. “Ardian Lloshi” dhe P.F. “Resul Çarçani”.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuarit vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI




MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Adelajda Roka



Nënshkruar më datë 25/03/2026